



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 119/ Prot.
2

Tiranë, më 16 /03/2017

VENDIM

Nr. 52, datë 16 / 3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. _____, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 119 Prot., datë 23.01.2017, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 21.12.2016 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

1. A ka një kontratë për vendosjen e kioskave në territorin e Bashkisë Tiranë?
2. Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të kontratës/ kontratave.
3. Cila është baza ligjore e kontratës/ kontratave të mësipërme?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr.119 Prot., datë 23.01.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr.119/1 Prot, datë 25.01.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 31.01.2017.

Pas kalimit të këtij afati, Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me dokumentacionin e kërkuar.

Nga shqyrtimi i ankimit dhe nga konsultimi i legjisllacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Theksojmë se, dokumentacioni i kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Çdo Autoritet Publik, bazuar në pikën e) të nenit 7 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duhet të ketë publik në programin e transparencës informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:

- a) listën e kontratave të lidhura;
- b) shumën e kontraktuar;
- c) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj kur rezulton se
- d) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 119 Prot., datë 23.01.2017, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës (Kopje të kontratës/ kontratave për vendosjen e kioskave në territorin e Bashkisë Tiranë; si edhe Bazën ligjore të kontratës/ kontratave të mësipërme") brenda datës 24.03.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 16. 3. 2017.

Besnik DERMISHI

KOMISIONERI